



UNIVERSITETI/UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË

# Raporti i vlerësimit të stafit administrativ për UIBM-në

---

"Ju e dini, ashtu siç e dinë shumica, që një Institucion është po aq e mirë sa njerëzit e tij. Pjesa e vështirë është në të vërtetë ndërtimi i ekipit që do të transmetojë kulturën e institucionit dhe t'ju çojë përpara."~ Kathryn Minshew,



## Hyrje

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (këtu e tutje: UIBM), si Institucion i Arsimit të Lartë (Këtu e tutje: IAL) themeluar që nga viti 2013, vazhdimisht ka bërë përpjekje që të bëjë të matshëm procesin e sigurimit të cilësisë. Për çdo vit, në UIBM janë organizuar pyetësorë me studentët dhe akter tjerë relevant, të cilët janë përgjigjur në pyetjet të cilat kanë pasur për qëllim të tregojnë gjendjen reale në UIBM përmes perceptimit të respondentëve.

UIBM ka mekanizmat e tij për matjen e cilësisë, dhe përveç që procesi matet dhe monitorohet në vazhdimësi nga ana e dekanëve, prodekanëve, koordinatorëve për cilësi në kuadër të fakulteteve, Zyra për Sigurim të Cilësisë në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (Këtu e tutje: ZSC) ka një rol të veçantë në këto zhvillime, dhe është organi kryesor brenda UIBM për matjen e cilësisë së brendshme.

Në muajin Maj 2021, në vazhden e aktiviteteve për të përmirësuar cilësinë brenda UIBM, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve, ZSC-ja ka realizuar pyetësorin me stafin administrative për opinionin e tyre për UIBM-në, si një proces tashmë i zakonshëm.

I gjithë procesi i plasimit (lansimit) të pyetësorëve dhe i mbledhjes së të dhënave është bërë nga ZCS-ja në koordinim të plotë me KQSCV-në.

Procesi ka qenë transparent, dhe të gjithë pyetësorët kanë qenë anonim duke respektuar kështu dinjitetin e secilit respondent dhe duke ruajtur prestigjin e institucionit.

## Zyra për Sigurim të Cilësisë (ZSC)



Zyra për Sigurim të Cilësisë është zyrë e pavarur e cila funksionon brenda Rektoriatit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (tutje UIBM) e cila raporton drejtpërdrejt te Rektori i UIBM-it.

ZSC angazhohet në rritjen e cilësisë në UIBM duke zbatuar të gjitha politikat institucionale dhe instrumentat matës të cilësisë të aprovuar nga Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimit (tutje KQSCV). Zyrarët e cilësisë nuk janë pjesë e stafit akademik të UIBM-it.

Zyra kryen matje të cilësisë duke përdorur të gjitha instrumentet e përfshira në pakon e instrumenteve matëse të cilësisë e aprovuar nga KQSCV. ZSC harton raporte që përmbajnë gjetje dhe rekomandime për secilën pyetësor të realizuar të cilët i dërgon te Rektori i UIBM-it. Zyra gjithashtu i dërgon gjetjet dekanëve të njëjësive akademike me qëllim të planifikimit të zhvillimit të stafit akademik dhe përmirësimit të vazhdueshëm.



## **Realizimi i pyetësorit**

Bazuar në planin e punës së ZSC-së dhe planin strategjik të UIBM-së, ZSC ka lansuar pyetësorin me stafin administrative në nivel të universitetit nga data 02 Prill 2021 deri me 16 Prill 2021. Pyetësori ka qenë anonim dhe të dhënat janë mbledhur dhe ruajtur nga ZSC përmes Sistemit Elektronik për Vlerësimin e Cilësisë - SEVC. Stafit administrativ janë përgjigjur përmes Sistemit të Menaxhimit Universitar (tutje SMU) në pyetësorin i cili ka përmbajtur 20 pyetjet të mbyllura dhe 1 pyetje të hapur, ku janë vlerësuar informimi, përgatitja profesionale, ngarkesa në punë, raportet profesionale, kushtet e punës dhe avancimi profesional.

## **Gjetjet e pyetësorit**

Nga të gjeturat përmes përgjigjeve të stafit administrativ vërejmë sinqeritetin dhe gatishmërinë e tyre për të kontribuar në avancimin dhe zhvillimin e UIBM-së.

Ky raport shprehë statistikën dhe rekomandimet e përgjithshme në nivel të UIBM-së që dalin nga tërësia e përgjigjeve.

Nga përgjigjet e marra dhe analizuar shohim që 93% e stafit administrative në UIBM janë të informuar për misionin e universitetit dhe fakulteteve, për vendimet si dhe 86% e tyre janë deklaruar që janë në vazhdimësi të informuar për të gjitha aktivitetet që organizohen në universitet.

Përgatitja profesionale e personelit administrative konsiderohet shumë e kënaqshme, ndërsa sa i përket shpërndarjes së ngarkesës në punë shohim që ka mendime të ndryshme ku 58% mendojnë që ka shpërndarje të barabartë të ngarkesës ndërsa 42% kanë mendim të kundërt.

Nga përgjigjet e stafit administrative 76% deklarojnë që janë të informuar me strategjinë e UIBM-së për zhvillim profesional të stafit administrative por në pyetjen rreth sugjerimeve të tyre për ngritjen e cilësisë në punë kanë sugjeruar trajnime profesionale për stafin administrativ që janë te parapara me strategji.

Raportet e stafit administrative me studentët, menaxhmentin dhe stafin administrative konsiderohen shumë të mira, por vihet re që stafi akademik jo gjithëherë i dorëzon me kohe raportet e nevojshme për



çështje të studentëve,. Pra 34% e stafit administrative konsiderojnë që personeli administrative nuk i dorëzon me kohe raportet e kërkuara.


Në përgjithësi apo 86% e stafi administrative kane deklaruar se menaxhmenti merr parasysh kërkesat e stafit administrativ, po ashtu 93% deklarojë që personeli administrativ ka nevojë për më shumë trajnime profesionale.

Stafi administrativ janë shumë të kënaqur (90%) me menaxhimin brenda fakultetit dhe ne nivel të UIBM-së dhe shprehen shume te kënaqur me marrjen parasysh të sugjerimeve të stafit për përmirësim.

Stafi administrativ kane deklaruar se bashkëpunimi me zyrën e teknologjisë informative konsiderohet si shume i mire.


Higjiena brenda kampusit universitar vlerësohet si shume e mirë siç janë deklaruar 93% e stafit administrativ.

Ambienti i punës si dhe kushtet e punës konsiderohen si shume i mire nga stafi administrativ dhe 93% e stafit administrativ konsiderohen shume te kënaqur që punojnë ne UIBM.






**2. Unë jam i/e informuar mirë për të gjitha aktivitetet që organizohen në Universitet dhe njësinë akademike ku unë punoj.**




**3. Përgatitja profesionale e personelit administrativ është e nivelit të kënaqshëm.**






**4. Ngarkesa me punë e personelit administrativ është e shpërndarë në mënyrë të barabartë.**




**5. Unë jam i informuar me strategjinë e UIBM për zhvillim profesional të stafit administrativ.**






**6. Unë jam i/e informuar për të gjitha vendimet që merren brenda universitetit.**




**7. Raportet e studentëve dhe personelit administrativ janë të mira.**






**8. Raportet në mes menaxhmentit të universitetit dhe personelit administrativ janë të mira.**




**9. Raportet e personelit administrativ dhe personelit akademik janë të mira.**








**10. Personeli akademik i dorëzon me kohë raportet e nevojshme për çështje të studentëve.**




**11. Kërkesat e personelit administrativ merren parasysh nga ana e menaxhmentit të universitetit.**






### 12. Personeli administrativ ka nevojë për më shumë trajnime profesionale




### 13. Unë jam i/e kënaqur me menaxhimin brenda fakultetit të cilit i përkas






**14. Unë jam i/e kënaqur me menaxhmentin e UIBM/Fakultetit**




**15. Unë jam i/e kënaqur me nivelin e mirëmbajtjes dhe higjienës nëpër kampus dhe kabinete**






**16. Sugjerimet e stafit administrativ për përmirësime merren parasysh nga menaxhmenti.**




**17. Ambienti i punës dhe kolegjialiteti është i mirë dhe më frymëzon për punë.**






**18. Kushtet në vendin e punës janë adekuate (zyra, paisjet etj)**




**19. Bashkëpunimi me zyrën e teknologjisë informative [SMU], është i mirë.**





### 20. Jam i /e kënaqur qe punoj në UIBM



### 21. Cili është sugjerimi juaj për përmirësimin dhe ngritjen e cilësisë së punës në tërësi?

- Të ketë më shumë trajnime profesionale.
- Të krijohet sistemi elektronik për menaxhimin e objektivave të UIBM-së
- Sistematizimi i punëtorëve konform detyrave, përgjegjësi dhe vëllimit të punëve, pagesa dhe stimulimet sipas vëllimit të punëve.
- Takime më të shpeshta, ndërmjet menaxhmentit dhe personelit administrativ.
- Bashkëpunimi i ngushtë i stafit akademik dhe administrativ në përmbushjen e misionit dhe vizionit të universitetit.
- Vazhdimi i zbatimit të strategjive dhe rregulloreve të UIBM-it
- Ngritja e kapaciteteve profesionale përmes vijimit të trajnimeve në fusha që bien mbi përgjegjësi të IAL
- Bashkëpunimi, edhe më efektiv dhe efikas, mes administratës, menaxhmentit, dhe stafit akademik, përmirësimi i kushteve të punës për stafin administrativ dhe akademik.



## **Rekomandimet**

- Pjesëmarrja me e madhe e stafit administrative në trajnimet e organizuara nga IKAP dhe motivimi për pjesëmarrje në trajnime të tjera profesionale sipas nevoje së stafit administrativ.
- Të ketë takime të rregullta mes stafit administrativ dhe menaxhmentit për arritjen e objektivave të përbashkëta.
- Të shikohet mundësia e krijimit të sistemit elektronik për manaxhimin e objektivave dhe aktiviteteve në UIBM.
- Të shikohet mundësia e stimulimit të stafi administrative sipas vëllimit të punëve.